Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

142/17
16.06.17

PSH.nr. 142/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina – Referues, z. Tefik Sylejmani- anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Audit Group"-Prishtinë, lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me pajisje për detektimin e heliumit" me nr. prok. KEKO 16/105/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës/ , në seancën e datës:15.06.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **HEDHET** poshtë si e palejuar ankesa e OE ankues "Audit Group"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje për detektimin e heliumit" me nr. prok. KEKO 16/105/121, për shkak të mungesës së dëshmimit të interesit juridiko material konform nenit 111 paragrafi 1 pika 1-8, lidhur me nenin 4.1.26 të LPP-së.

II. **VËRTETOHET,** vendimi i AK-së (KEK), për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje për detektimin e heliumit" me nr. prok. KEKO 16/105/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës/.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Audit Group"-Prishtinë është hedhur poshtë si e palejuar, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:04.10.2016.

Hapja e ofertave është bërë me dt:20.07.2016, ku kanë marr pjesë dhjetë operator ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me dt:25.04.2017.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës operatori ekonomik "Audit Group"-Prishtinë me dt:02.05.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt:05.05.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Audit Group"-Prishtinë

Operatori ekonomik ankues "Audit Group"-Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 18 maj 2017 me nr. 147/17 kundër njoftimit për dhënie te kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit, "Furnizim me pajisje për detektimin e heliumit" me nr. prok. KEKO 16/105/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK Korporata Energjetike e Kosovës duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së.

- Neni 7 Barazia në trajtim (jo- Diskriminimi)
- Neni 56 *Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave*
- Neni 59 *Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve*
- Neni 60 *Kriteret për Dhënien e Kontratës*
- Neni 72 Dokumentacioni dhe (informacioni shtesë)

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues-teknik në raportin e dt: 05.06.2017 i kanë propozuar panelit shqyrtues që ky aktivitet i prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje për detektimin e heliumit'' me nr prokurimit KEKO 16/105/121, të anulohet në tërësi, ndërsa ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar

Operatori ekonomik ankues përmes përgjigjes me shkrim të dt:06.06.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 15.06. 2017, e cila është mbajtur pa praninë e palëve konform nenit 26 paragrafi 1 të Rregullores së punës së OSHP-së, kanë qenë prezent paneli shqyrtues dhe eksperti shqyrtues u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues deklaroj: "qëndrojë pranë raportit të dt:05.06.2017.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesve të ankesave, sqarimeve dhe rekomandimit të ekspertëve të OSHP-së, parashtresave të palëve në procedurë, konstaton se operatori ekonomik ankues është i pa përgjegjshëm pasi që nuk i ka të gjitha certifikatat ISO ashtu siç i ka cekur autoriteti kontraktues në letrën standarde për tenderues të eliminuar.

Duke pasur parasysh faktet e lartpërmendura, rezulton se operatori ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit është palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1-8 i LPP-së, pasi që në asnjë mënyrë ky OE ankues nuk ka mundur të dëshmojë se shkelja e supozuar i është kërcënuar ti shkaktojë dëme këtij operatori ekonomik dhe njëkohësisht me këto rrethana dhe fakte, i njëjti operator në asnjë variant nuk ka mundur të shpallet fitues i këtij tenderi.

Lidhur me pretendimet e OE ankues për OE të rekomanduar për kontratë, paneli shqyrtues sqaron se këto pretendime janë sqaruar në vendimin e panelit shqyrtues me Nr.07/17 të dt:24.02.2017 ku është sqaruar se operatori ekonomik "Era Trade" ka ofruar autorizim për pjesën kryesore që është Pfeiffer Vacum, ndërsa të gjitha pjesët tjera shkojnë me këtë pjesë kryesore. Gjithashtu edhe për këto pozicione për pjesë të vogla e të cilat mbulojnë përafërsisht 5 % të këtyre pjesëve, përfaqësuesi i operatorit ekonomik "Era Trade" i ka prezantuar autorizimet në seancën e kaluar, mirëpo që edhe mungesat në 5 % të pjesëve të vogla mund të konsiderohen devijime të vogla konform nenit 59 paragrafi 4 të LPP-së, pasi që ky fakt nuk e ndryshon kushtin material dhe substancën.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Korporata Energjetike e Kosovës

1x1 OE "Audit Group"-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.